



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 773/2018

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 15.11.2018 shqyrtoi ankesat përkatësisht me:

Objekt:

Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k., në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-77354-07-02-2018, me objekt “Ndërhyrje në Infrastrukturën e Rrugës Andrea Papaj, Degëzimi 1, Degëzimi 2”, me fond limit 22.083.346,20 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

Shtim i arsyeve të skualifikimit të operatorëve ekonomikë “Sireta 2F” sh.p.k. dhe “Pepa Group” sh.p.k., në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues:

“Sireta 2F” sh.p.k.
Njësia Administrative Paskuqan, Tiranë

“GPG Company” sh.p.k.
Lushnje, Kodi postar 9001

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Lushnje
Lagja “Kongresi i Lushnjes”, Lushnje

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.4. Kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.07.2018, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-77354-07-02-2018, me objekt “Ndërrhyrje në Infrastrukturën e Rrugës Andrea Papaj, Degëzimi 1, Degëzimi 2”, me fond limit 22.083.346,20 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.

II.2. Në datën 03.08.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Nga verifikimi në sitimin e prokurimit elektronik (SPE) si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 23.08.2018 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesmarrës në këtë procedurë prokurimi të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Shkëlqimi 07” sh.p.k.	13.000.000 lekë, skualifikuar
2. “Beqiri” sh.p.k.	16.011.537 lekë, skualifikuar
3. “Fled” sh.p.k.	17.114.368 lekë, skualifikuar
4. “Sireta 2F” sh.p.k.	18.339.294 lekë, skualifikuar
5. “Company Riviera 2008” sh.p.k.	19.079.069 lekë, skualifikuar
6. “G.P.G Company” sh.p.k.	19.270.476 lekë, kualifikuar
7. “Senka” sh.p.k.	20.050.038 lekë, kualifikuar
8. “Boshnjaku B” sh.p.k.	21.930.142 lekë, skualifikuar
9. “Llazo” sh.p.k.	21.611.434 lekë, kualifikuar
10. “Pepa Group” sh.p.k.	Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike

II.4. Në datën 23.08.2018, operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. është njoftuar elektronikisht për vlerësimin e procedurës së prokurimit si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë për arsyet si më poshtë vijon:

“Shoqeria ka paraqitur dokumentacion ligjor vetem per nje mjete e llojit kamioncine deri 3.5 t. Mjete me targa AA698 MZ i paraqitur si kamioncine, bazuar ne dokumentacionin ligjor dhe fotot e paraqitura nuk eshte kamioncine deri ne 3.5ton, por nje kamion me autiovinc deri 7.5 ton. Kjo mangesi bie ne kundërshtim me Dokumentat Standarte te Tenderit , Shtojca nr 12 , Kriteret e Vecanta te Kualifikimit , Kapaciteti Teknik , pika 6, pasi shoqerise nuk ka disponueshmerine e nje kamioncine deri 3.5 ton.”

II.4.1. Operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. në datën 27.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar skualifikimin e ofertës së tij ekonomike në procedurën e prokurimit, sipas pretendimeve si më poshtë vijon:

[...] Ne lidhje me arsyetimet qe ju keni dhene, Autoriteti Kontraktor dhe Komisioni i Vleresimit te ofertave eshte plotesisht gabim dhe skualifikimi per keto arsye eshte totalisht i padrejte dashakeqes dhe mbi te gjitha i pabazuar ne ligj. Per me teper ju japim te gjitha arsyetimet logjike dhe te bazuara ne ligj si me poshte: Nga verifikimi i dokumentave te paraqitura per kamioncinat referuar dokumentit leje qarkullimi, ne te cilen konstatohen te gjitha te dhenat ne lidhje me parametrat e mjetit, ndermjet te cilave dhe kapaciteti mbajtes, ne murin rendor 23 dhe 24 jane perkatesisht: kamion me kapacitet deri ne 3.5 ton eshte paraqitur dokumentacioni per kamioncinat me targa: AA698MZ me kapacitet 3.1 ton dhe TR 4694P me kapacitet 1.13 ton, kjo mund te vertetohet lehtesisht nepermjet lejes se qarkullimit te paraqitur ne dokumentacionet e vertetesise se mjetit. Sic dihet kapaciteti i mjetit behet duke llogaritur Peshen maksimale te autorizuar (pika 23) duke zbritur Masen e mjetit bosh (pika 24). Per mjetin me Targe AA 698 MZ sipas lejes se qarkullimit Masa e Maksimale e autorizuar 7500 duke i zbritur masen e mjetit bosh 4400 del kapaciteti mbajtes 3.1 ton, gjithashtu ky mjet ka dhe nje funksion plus qe ka te montuar nje vinc

gje e cila ja shton funksionet dhe eshte ne favor pasi kryen me shume funksione dhe shpejton proceset e disa punimeve. Mjetet e paraqitura nga shoqeria "Sireta 2F" Shpk jane te shoqeruar me te gjitha dokumentacionin e kekuar si: regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikate transporti nga bashkia, (te vlefshme), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, nga te cilen ky dokumentacion eshte permbushur nga shoqeria jone ne tenderin qe eshte prokuruar nga Bashkia Lushnje. Kemi bindjen se jane te paket Operatoret Ekonomik qe zoterojne nje dokumentacion te plote dhe kaq te sakte sic i disponon shoqeria "Sireta 2F" shpk. Mbi arsyen qe autoriteti kontraktor ka ngritur, qe "Sireta 2F" shpk nuk ka paraqitur kamioncine deri ne 3.5 ton eshte plotesisht i pa drejte dhe diskriminus pasi, eshte lehtesisht e verifikushme qe "Sireta 2F" shpk ka kapacitet te mjaftushem dhe madje i tejkalon cdo kriter te vene ne DST nga autoniteti juaj.

Referuar frymes se legjislacionit per prokurimin publik vendosja e kriterëve te vecanta per kualifikim ka si synim kryesor qe ti sherbej autoritetit kontraktor per njohjen e giendjes dhe kapacitetet e operatori ekonomik te cilit nepermjet dokumentacionit te paraqitur verteton qe zoteron dokumentacionin dhe kualifikimin e nevojshem, pervojen e duhur ku gjithcka eshte ne funksion te realizimit me sukses te kontrates. Gjate vlersimit te ofertave nuk jane marre ne konsiderat kriteret dhe parimet e legjislacionit per prokurimet publike nga ana e Komisionit te Vlersimit te Ofertave dhe per pasoje KVO eshte ne shkelje te nenit 46, 55, por jo vetem te ligjit nr 9643 date 20.11.2006 "Per Prokurimit Publik" te ndryshuar, dhe VKM 914 date 29. 12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, duke favorizuar subjektin qe ka oferte me te larte se oferta e operatorit ekonomik "Sireta 2F" shpk. Neni 63 pika 1 e LPP cituar [...]. Gjithashtu, ne nenin 63 pika 2 te LPP cituar [...]. Duke qene se ne kemi bindjen te thella se vendimi i mesiperme eshte teresisht i pabazuar dhe jo ne perputhje me ligjin e prokurimit publik paraqesim ankesen si me poshte vijon: Bazuar ne nenin 53, pika 3 te ligjit "Per Prokurimin Publike" cituar [...]. Sa me siper, duke qene te bindur se shoqeria jone ploteson te gjitha kapacitetin teknik ekonomik dhe ligjor duke permbushur te gjitha kriteret e kualifikimit. Prandaj kerkojme: shqyrtimin e ankeses sone, pezullimin e proedures se prokurimit deri ne marren e nje vendimi te drejte nga ana e Autoritetit Kontraktor, ne te kundert ne baze te te drejtave qe na jep ligji ne Republiken e Shqiperise do te vazhdojme proedurat e metejshme te ankimimit edhe ne Komisionin e Prokurimit Publik.

II.4.2. Në datën 31.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës me nr. 6032 prot. datë 31.08.2018, duke e refuzuar ankesën me argumentimin si më poshtë vijon:

[...]Ne ankesen qe ka bere shoqeria kerkon ndryshimin e vendimit te AK duke kualifikuar subjektin "Sireta 2F" shpk si dhe ne ankesen qe ka bere subjekti pretendon se eshte skualifikuar pa te drejte per arsyet e meposhtme:

1. Nga Shoqeria eshte paraqitur dokumentacion ligjor vetem per nje mjet e llojit kamioncine deri 3.5 ton. Mjeti me targa AA698 MZ i paraqitur si kamioncine, bazuar ne dokumentacionin ligjor dhe fotot e paraqitura nuk eshte kamioncine deri ne 3.5 ton, por nje kamion me autovinc deri 7.5 ton. Kjo mangesi bie ne kundershtrim me Dokumentat Standarte te Tenderit Shtojca nr 12, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6, pasi shoqerise nuk ka disponueshmerine e nje kamioncine deri 3.5 ton.

Nga shqyrtimi qe iu krye dokumentacionit te tenderit te publikuar ne faqen elektronike zyrtare te Agjensise se Prokurimit Publik www.app.gov.al dhe dokumentacionit ne dosjen e tenderit rezulton

se: a) Persa i perket arsyetimit qe ka paraqitur ky operator per peshen e mjetit me targa AA698 MZ, sqarojme se kapaciteti i ketij mjetit eshte i percaktuar saktesisht ne gjithë dokumentacionin e paraqitur per kete mjet si kamion me vinc me poshte rradhisim:

- Certifikata e pronesisë se mjetit rrugor- e paraqet Kamion
- Certifikata e kontrollit teknik te mjeteve rrugore ne rubriken Tipi i mjetit rrugor, e paraqet Kamion nga 3.5 deri ne 7.5 ton.
- Polica per sigurimin e mjeteve ne rubriken kapaciteti mbajtes e paraqet 7500 kg;
- Leja e qarkullimit ne piken 1, ku specifikon llojin e mjetit e paraqet Kamion

Ne perfundim Komisioni i Vleresimit te Ofertave nuk ka pse te beje interpretim te dokumentacionit te mjetit duke bere zbritjen e pretenduar, kur lloji i mjetit dhe tonazhi eshte shprehur qarte dhe sakte ne dokumentacionin e sipershkruar. Për sa më lart ankesa juaj nuk merret parasysht. [...]

II.4.3. Në datën 06.09.2018 operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor. Në ankesën pranë Komisionit të Prokurimit Publik, operatori ekonomik ankimues ka shtuar gjithashtu:

“...theksojmë se Ak, në Kriteret e Vecanta për Kualifikim, Kapaciteti Teknik, pika 6, Disponimi i mjeteve të mëposhtme: Konkretisht (Kamioncinë deri 3.5 ton) për të cilët nuk është specifikuar në mënyrë eksplicite që deri në 3.5 ton është kapaciteti mbajtës apo pesha totale. Nëse do të ishte kërkuar një gje e tillë shoqëria jonë do të paraqiste mjetet e kërkuara pasi disponon një numër shumë të madh të mjeteve sa janë kërkuar në këtë tender. [...]”

II.5. Operatori ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k. në datën 30.08.2018 ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke ngritur pretendime mbi operatorët ekonomikë “Sireta 2F” sh.p.k. dhe “Pepa Group” sh.p.k., pjesëmarrës në procedurën e mësipërme të prokurimit. Konkretisht, operatori ekonomik ankimues pretendon:

[...] Ne operatori ekonomik “G.P.G Company” shpk kemi marre pjese ne proceduren e tenderit “Nderhyrje ne infrastrukturen e rruges Andrea Papaj, degezimi 1 dhe degezimi 2”, te organizuar nga Bashkia Lushnje me date 03.08.2018. Me vendimin e dates 23.08.2018 komisioni vleresimit te ofertave ka njoftuar perfundimin e vleresimit te ketij tender per te gjithë operatoret pjesemarrës ne tender. Nisur nga fakti se ne sistemin e prokurimit publik me date 24.08.2018 eshte bere nje ankese nga ana operatori ekonomik "Sireta 2F" si dhe nga operatori ekonomik "Pepa Group" kerkojme qe te rivleresohet vendimi i komisionit te vleresimit te ofertave ne lidhje me arsyet e skualifikimit te ketyre dy operatoreve ekonomik duke gene se nga nje vezhgim kujdesshem ne buletinin e njoftimit publik Autoritetet Kontraktore te tjera kane konstatuar se kane mangesi te theksuara ne lidhje me kapacitetin ligjor, financiar dhe teknik. Nisur nga sa parashtroam me siper kerkojme te rivleresohet vendimi i KVO-se i dates 23.08.2018 ne lidhje me arsyet e skualifikimit te operatoreve ekonomik "Sireta 2F" dhe "Pepa Group".

II.5.1. Referuar ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit nuk ka paraqitur asnjë kthim përgjigje nga ana e autoritetit kontraktor. Ndërkohë që, sipas informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor, në datën 06.09.2018, ky i fundit i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues, nëpërmjet shkresës me nr. 6167/2 prot., duke e refuzuar ankesën.

II.5.2. Në datën 17.09.2018 operatori ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k. ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik duke ngritur të njëjtat pretendime si në ankesën e ngritur pranë autoritetit kontraktor.

II.6. Nëpërmjet shkresës nr. 6364 prot., datë 14.09.2018, protokolluar me tonën në datën 17.09.2018 si dhe shkresës nr. 6655 prot., datë 26.09.2018, protokolluar me tonën në datën 28.09.2018 me objekt “Shkresë përcjellëse” është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesave të operatorëve ekonomikë ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Sireta 2F” sh.p.k. për kundërshtimin e arsyes së skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se: “Nga verifikimi i dokumentave të paraqitura për kamioncinat referuar dokumentit leje qarkullimi, në të cilën konstatohen të gjitha të dhënat në lidhje me parametrat e mjetit, ndërmjet të cilave dhe kapaciteti mbajtes, në murin rëndor 23 dhe 24 janë perkatesisht: kamion me kapacitet deri në 3.5 ton është paraqitur dokumentacioni për kamioncinat me targa: AA698MZ me kapacitet 3.1 ton dhe TR 4694P me kapacitet 1.13 ton, kjo mund të vërtetohet lehtësisht nëpërmjet lejes së qarkullimit të paraqitur në dokumentacionet e vërtetuesive të mjetit. Sic dihet kapaciteti i mjetit bëhet duke llogaritur Peshën maksimale të autorizuar (pika 23) duke zbritur Masën e mjetit bosh (pika 24). Për mjetin me Targë AA 698 MZ sipas lejes së qarkullimit Masa e Maksimale e autorizuar 7500 duke i zbritur masën e mjetit bosh 4400 del kapaciteti mbajtes 3.1 ton, gjithashtu ky mjet ka dhe një funksion plus që ka të montuar një vinc gje e cila ja shton funksionet dhe është në favor pasi kryen me shumë funksione dhe shpejton proceset e disa punimeve”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 12 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.3.6 e “Kapacitetit teknik”, nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri:

6). Disponimi i mjeteve të mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Eskavator me goma	Cope 2	Pronësi ose me qera
Fadrome	Cope 1	Pronësi ose me qera
Grejder	Cope 1	Pronësi ose me qera
Mjet transporti vetëshkarkues mbi 10 ton	Cope 3	Pronësi ose me qera
Kamioncine deri 3.5 ton	Cope 2	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	Cope 1	Pronësi ose me qera
Asfaltoshtruese	Cope 1	Pronësi ose me qera

<i>Autobot uji</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Bobcat</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrul ngjeshes</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Autovinc</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Motogjeneratore</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Instrument per punime gjeodezike</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrike betoni</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera ose aktmarveshje furnizimi</i>
<i>Deflektometer per matjen e shtresave</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Rrull vibrues</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Makineri vijezi</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera</i>
<i>Fabrike asfaltbetoni</i>	<i>Cope 1</i>	<i>Pronësi ose me qera ose aktmarveshje furnizimi</i>

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), certifikate transporti nga bashkia, (te vlefshme), certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjeti , foto mjeti dhe kur jane me qera, leje qarkullimi, certifikate transporti nga bashkia, (te vlefshme) certifikaten e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit dhe foto e mjetit te shoqeruara me kontraten perkatese te qerese e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates.*
- *Per mjetet dhe pajisjet e tjera qe nuk kane leje qarkullimi ofertuesi duhet te paraqesë kontrate noteriale te blerjes ose fatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te mjetit.*
- *Për fabriken e betonit dhe asfalto betonit ne rast se eshte ne pronesi duhet te paraqitet dokumenti qe verteton pronesine, Leja mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit.*
Ne rast se Fabrika e asfaltbetonit dhe betonit eshte me qera duhet te paraqitet kontrata e qerese noteriale me afat deri ne realizimin e plote te kontrates objekt prokurimi e shoqeruar me dokumente qe vertetojne pronesine e tyre, Lejen mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit ose nga Ministria e Mjedisit.
Ne rast se fabrika e asfaltbetonit nuk eshte ne pronesi ose me qera te paraqitet nje kontrate furnizimi noteriale me afat deri ne realizimin e plote te kontrates objekt prokurimi, te lidhur me furnizuesin shoqeruar edhe me dokumentat e pronesise te furnizuesit dhe Lejen mjedisore Kodi III.1B leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit.
- *Ofertuesi se bashku me dokumentat e mesiperm duhet te paraqese te plotesuar e te nenshkruar edhe Deklaraten sipas Shtojces 9 te DST.*

III.1.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik nga operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k., për përmbushjen të kriterit të mësipërm, rezulton se ky i fundit ka paraqitur dokumentacion si më poshtë vijon.

- Deklaratë ”Mbi disponimin e makinerive” e operatorit ekonomik ”Sireta 2F” sh.p.k.
- Certifikatë e pronësisë së mjetit me targë AA698MZ.
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik

- Siguracionin e mjetit
- Foto e mjetit
- Kontratë Qeraje Nr.2686 rep., Nr. 2629 kol., datë 02.05.2018, për marrjen me qera të mjetit Kamioncinë, me targë TR4694P, ndërmjet qeradhënësit Z.Sh.D dhe qeramarrësit shoqëria "Sireta 2F" sh.p.k.
 - Certifikatë e pronësisë së mjetit rrugor TR4694P, në emër të Z.Sh.D.
 - Leje qarkullimi
 - Certifikatë e kontrollit teknik
 - Siguracionin e mjetit

III.1.3. Në nenin 46, pika 1/b e ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : *"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]"*

III.1.4. Në nenin 26, pika 8/c të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar parashikohet se *"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën."*

III.1.5. Ndërsa në nenin 26 pika 5 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar parashikohet se *"Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve"*.

III.1.6. Në ligjin Nr.8378, datë 22.07.1998 "Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, nenin 54, pika 1/c, parashikohet:

"c) automjet për transport të përzier: mjet që ka një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë, ose 4.5 tonë kur ka tërheqje elektrike a me bateri; janë të destinuara për transport njerëzish dhe mallrash me kapacitet maksimal nëntë ndenjëse, duke përfshirë edhe ndenjësen e drejtusit të mjetit;"

Ndërsa në pikën 2 të po këtij neni parashikohet: *"Në aktet në zbatim përcaktohen, sipas pajisjeve të tyre shoqëruese, tipat e automjeteve që regjistrohen si automjete për transporte të veçanta dhe si automjete për përdorime të veçanta."*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin

ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.1.8. Nga verifikimi në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. rezulton i skualifikuar nga procedura e mësipërme e prokurimit me arsyetimin se *“Shoqeria ka paraqitur dokumentacion ligjor vetem per nje mjet e llojit kamioncine deri 3.5 t. Mjeti me targa AA698 MZ i paraqitur si kamioncine, bazuar ne dokumentacionin ligjor dhe fotot e paraqitura nuk eshte kamioncine deri ne 3.5 ton, por nje kamion me autovinc deri 7.5 ton. Kjo mangesi bie ne kundërshtim me Dokumentat Standarte te Tenderit, Shtojca nr 12, Kriteret e Vecanta te Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 6, pasi shoqeria nuk ka disponueshmerine e nje kamioncine deri 3.5 ton [...]”* Nga shqyrtimi i dokumentave të tenderit, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit duhet të paraqesin dokumentacionin e nevojshëm me anë të të cilit të vërtetojnë se disponojnë dy kamioncine deri në 3.5 ton.

Në verifikim të përmbushjes së kriterit për mjetet kamioncinë, që është edhe arsyeja e skualifikimit të dhënë nga autoriteti kontraktor, rezulton se, operatori ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. për këtë kriter ka paraqitur deklaratën mbi disponimin e mjeteve, ku deklaron që disponon dy kamioncine, me targë AA698MZ dhe TR4694P, si dhe dokumentacionin përkatës për këto dy mjete, konkretisht çertifikatën e pronësisë së mjetit me targë AA698MZ, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit si dhe foto të mjetit. Gjithashtu, kontratën e qerasë Nr.2686 rep., Nr. 2629 kol., datë 02.05.2018, për marrjen me qera të mjetit me targë TR4694P, ndërmjet qeradhënësit Z.Sh.D dhe qeramarrësit shoqëria “Sireta 2F” sh.p.k., çertifikatë e pronësisë, lejen e qarkullimit, certifikatën e kontrollit teknik si dhe siguracionin e mjetit.

Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht, mjeti me targë AA698MZ, i paraqitur nga ky i fundit në përmbushje të kriterit për mjetin kamioncinë, referuar lejes së qarkullimit, rezulton se, kalon kapacitetin 3.5 ton që parashikohet si kapacitet maksimal për mjetet e transportit të përzier. Sqarojmë se, referuar legjislacionit të fushës përkatëse, si më sipër cituar, konkretisht Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, në nenin 54, pika 1/c të tij parashikohet se në automjetet për transport të përzier përfshihen mjetet të cilat kanë një peshë të përgjithshme me ngarkesë të plotë jo më të madhe se 3.5 tonë [...]. Si rrjedhim në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri që duhet të paraqitet dokumentacion për mjetet kamioncine me kapacitet deri në 3.5 tonë, që në kuptim të legjislacionit në fuqi për qarkullimin rrugor këto mjete nuk duhet të tejkalojnë kapacitetin maksimal 3.5 ton, konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk ka arritur të vërtetojë se disponon mjete të tilla duke mos e plotësuar kështu kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për mjetin kamioncinë.

Akoma më tej, nga verifikimi i dokumentacionit që operatori ka paraqitur për këtë mjet, konstatohet që, në certifikatën e pronësisë së këtij mjeti, tek “Të dhënat mbi identifikimin dhe karakteristikat teknike të mjetit” cilësohet lloji ‘Kamion’ dhe ‘Kamion me vinç i montuar’. Gjithashtu në lejen e qarkullimit dhe certifikatën e kontrollit teknik është cilësuar lloji i mjetit “Kamion”. Pra sa më sipër, referuar arsyes së skualifikimit, nga verifikimet e kryera konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk plotëson kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor për paraqitjen e dy kamioncinave sipas kërkesave në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues “G.P.G Company” sh.p.k. mbi operatorët ekonomikë “Sireta 2F” sh.p.k. dhe “Pepa Group” sh.p.k., me pretendimin se “Nisur nga fakti se ne sistemin e prokurimit publik me date 24.08.2018 është bere nje ankese nga ana operatori ekonomik "Sireta 2F" si dhe nga operatori ekonomik "Pepa Group" kerkojme qe te rivleresohet vendimi i komisionit te vleresimit te ofertave ne lidhje me arsyet e skualifikimit te ketyre dy operatoreve ekonomik duke qene se nga nje vezhgim kujdesshem ne buletin e njoftimit publik Autoritetet Kontraktore te tjera kane konstatuar se kane mangesi te theksuara ne lidhje me kapacitetin ligjor, financiar dhe teknik”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Neni 63, pika 1, i Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), me titull “Të drejtat e personit të interesuar” parashikon se: “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin”.

III.2.2. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se një person fizik apo juridik, kur dorëzon një ankim, duhet të paraqesë (argumentojë) se të drejtat e tij të mbrojtura nga legjislacioni janë dëmtuar si rezultat i një vendimi, mase apo të ndonjë veprimi tjetër zyrtar nga ana e një autoriteti kontraktor. Nëse ai dështon në sa më sipër, atëherë ankimi në KPP është i papranueshëm.

Neni 63, pika 1, kërkon shprehimisht që ankimuesi, jo vetëm të ketë interes, por edhe të jetë dëmtuar realisht apo të rrezikohet të dëmtohet nga vendimi që ka marrë autoriteti kontraktor.

Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimues ngre pretendime mbi operatorin ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k., i cili rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit që me vendimin e KVO-së datë 23.08.2018, si dhe ngre pretendime mbi operatorin ekonomik “Pepa Group” sh.p.k. i cili, referuar klasifikimit të autoritetit kontraktor rezulton se nuk ka paraqitur ofertë ekonomike në këtë procedurë prokurimi.

Sa më sipër, KPP konstaton se, referuar nenit 63 pika 1 të LPP-së, interesi i ligjshëm i operatorit ekonomik ankimues nuk është dëmtuar nga asnjë veprim i autoritetit kontraktor, kështu që, rrjedhimisht ky operator ekonomik nuk legjitimohet të paraqesë ankesë për këtë procedurë prokurimi.

III.2.3. Akoma më tej. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë K.P.P, operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* për të gjithë kriteret në total, duke ngritur dyshime e hamendësime, nëse i plotësojnë kriteret e vendosura në DST operatorët e kualifikuar.

III.2.4. Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshëm të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 20, “Forma dhe përmbajtja e ankesës”, pika 3:

- Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;”

III.2.5. Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta ose dokumentacionin përkatës, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë.

Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e Autoritetit Kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e KVO-së dhe të rivlerësojë në themel procedurën e prokurimit publik.

III.2.6. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për mospërmbushjen e kriterit/kritereve nga ana e operatorëve ekonomikë të tjerë.

Theksojmë se mospërmbushja e kriterit apo kushteve të vendosura nga autoriteti kontraktor mund të vijë për shkaqe të ndryshme, siç janë mosparaqitja e një dokumenti të kërkuar, ose problematika që mund të prekin dokumentin etj. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për mospërmbushje kriteri/kriteresh.

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik thekson dallimin e qartë – në gjykimin e tij, ndërmjet një pretendimi të një operatori ekonomik që ngre shqetësim mbi vlerësimin hipotetikusht të gabuar të ofertës së vetë atij nga ana e autoritetit kontraktor, nga njëra anë dhe, pretendimit/prendimeve të këtij operatori apo të cilitdo operatori pjesmarrës në një procedurë prokurimi publik ndaj mënyrës së vlerësimit të autoritetit kontraktor për operatorët e tjerë konkurrentë në këtë procedurë, nga ana tjetër.

III.2.8. Në rastin e parë, kur interesi është absolut dhe i drejtpërdrejtë, barra e provës për të argumentuar shkeljet e pretenduara të autoritetit, ndonëse sërish qëndron mbi ankimesin, në gjykimin e KPP është arsyeshmërisht më e lehtë. KPP e mirëkupton pozitën e operatorit dhe, në kuptim të misionit të tij për të siguruar efincencën e procedurave të prokurimit publik, përmes nxitjes së pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë, vlerëson se duhet të adoptojë një qëndrim *pro-aktiv*, në krahasim të operatorit ankimes. Në rastin e dytë, kur operatorit pjesmarrës në një procedurë ankohet në lidhje me ofertat e operatorëve konkurrentë, pesha specifike e barrës për të provuar paligjshmërinë hipotetike të këtyre të fundit është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se përse vlerësimi i autoritetit kontraktor ka qenë i gabuar, sipas ankimesit.

III.2.9. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të ofertës së konkurrentit/konkurrentëve të kualifikuar përpara tij ose të barabartë me të në ofertë ekonomike, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2.10. KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (prendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument, por vetëm mbi pretendime hipotetike e dyshime të paarsyeshme.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k. nuk qëndrojnë.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Sireta 2F” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me nr. REF-77354-07-02-2018, me objekt “Ndërhyrje në Infrastrukturën e Rrugës Andrea Papaj, Degëzimi 1, Degezimi 2”, me fond limit 22.083.346,20 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datë 03.08.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Lushnje.
 2. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “G.P.G Company” sh.p.k. për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
 5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1464 Protokolli
Datë 06.09.2018

Nr. 1492 Protokolli
Datë 17.09.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha